

VENDIM
Nr. 635, datë 15.7.2015

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1252, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË
TENDERIT PUBLIK PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË
FREKUENCAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, e 69, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 2.2, të kreut II, shtohen fjalët “... mënyrat e pagesës për autorizimin individual.”;

b) Në kreun III bëhen shtesat e mëposhtme:

i) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 1.2, shtohen fjalët “... përfshirë dhe miratimin për mënyrat e pagesës ...”.

ii) Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.2.1, me këtë përmbajtje:

“1.2.1 Aplikimi i pagesës me këste në një procedurë për dhënien e autorizimit individual miratohet nga ministri në momentin e dhënies së miratimit për procedurën sipas shkronjës “b”, të pikës 1.2, të këtij kreu, në rastet kur:

a) Aplikimi i pagesës me këste përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës;

b) subjekte të interesuara në procesin e këshillimit kanë kërkuar dhe argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut;

c) procedura për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur.”.

iii) Në fund të pikës 10.1 shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e pagesave. Kalendar i pagesave nuk mund të jetë më shumë se një vit dhe pagesa e parë jo më pak se 20% e çmimit të ofertës. Aplikimi i pagesës me këste nuk e cenon të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.”.

iv) Në fund të pikës 11.1 shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, afati kohor i sigurimit të ofertës është të paktën 30 ditë më shumë se kalendar i pagesave të propozuara sipas pikës 10.1, të këtij kreu.”.

v) Në fund të pikës 19.3 shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, autorizimi individual lëshohet nga AKEP-i pas kryerjes së pagesës së parë. Kalendar i pagesave përfshihet në kushtet e autorizimit individual.”.

c) Pas pikës 1.2, të kreut V, shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 Kur aplikohet pagesa me këste, në dokumentin e tenderit përcaktohet koha për pagesën e parë. Ofertuesi do të paguajë brenda vitit, sipas kalendarit të propozuar në ofertë, pagesat e tjera respektive pas pagesës së parë plus interesin mbi këtë pagesë të llogaritur sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës. Pagesat do të derdhen prej ofertuesit që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të tenderuar në buxhetin e shtetit. Moskryerja sipas afatit e

pagesave me këste duke filluar nga pagesa e dytë çon në revokimin e autorizimit individual nga AKEP-i dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama